



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 3071/Prot.

Tiranë, më , 30.01 2023

VENDIM

Nr. 06 datë 30.01.2023

**PËR MIRATIMIN E PLANIT STRATEGJIK MBI ZHVILLIMIN
PROFESIONAL TË PERSONELIT NË UNIVERSITETIN E TIRANËS 2023-2028, SI
EDHE PROGRAMIN E TRAJNIMIT PËR VITIN 2023**

Bazuar në nenin 38, pika 1, gërma b), të ligjit të arsimit të lartë nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; në nenin 31, gërma ç), të Statutit të UT-së; si edhe në materialin e përgatitur nga Grupi i Punës, i ngritur me Urdhërin e Brendshëm nr. 26, datë 08.11.2022, të Rektorit, në kuadër të strategjisë së Universitetit të Tiranës për vitet 2023-2028, pas miratimit në parim edhe nga Rektorati i UT-së, në mbledhjen e tij, datë 23.01.2023, Senati Akademik i UT-së, në mbledhjen e tij, datë 30.01.2023,

VENDOSI:

1. Miratimin e planit strategjik mbi zhvillimin profesional të personelit në Universitetin e Tiranës 2023-2028, si edhe programin i trajnimit për vitin 2023.
2. Vendimi t'i përcillet Bordit të Administrimit të UT-së për miratim përfundimtar, dhe më pas Qendrës Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimeve të UT-së, për zbatimin e tij.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Artan Hoxha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

**PLANI STRATEGJIK MBI ZHVILLIMIN PROFESIONAL TË PERSONELIT
NË UNIVERSITETIN E TIRANËS 2023-2028**

DHE

PROGRAMI I TRAJNIMIT PËR VITIN 2023

Grupi i Punës:

Prof. Asoc. Dr. Etleva Leskaj

Dr. Blerina Kërçuku

Dr. Valbona Ndrepepaj

Tiranë, 2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

1. Hyrje

Në shoqëritë e sotme, universitetet ofrojnë një kontribut të rëndësishëm për zhvillimin social, ekonomik, politik dhe kulturor të vendit. Për këtë arsye, zhvillimi personal, profesional, trajnimi dhe edukimi i vazhdueshëm për personelin e një universiteti, e në veçanti për Universitetin e Tiranës, si institucioni më i madh i arsimit të lartë në vend, duhet të jetë një proces ciklik, sistematik dhe i rëndësishëm, nëpërmjet të cilit, realizohet përditësimi i dijeve dhe aftësive të personelit për gjatë gjithë jetës. Universiteti i Tiranës, më qëllim garantimin e përditësimit të dijeve dhe aftësive të personelit për gjatë gjithë jetës dhe zhvillimin e tyre, ka hartuar *Planin Strategjik mbi Zhvillimin Profesional të Personelit 2023-2028*.

Ky Plan Strategjik, i cili është ndërtuar pas vlerësimit dhe egzaminimit të nevojave të personelit të UT-së, është një dokument i cili përcjell vlerë të shtuar dhe një mjedis miqësor për personelin, një mjedis i cili nxit, garanton dhe lejon zhvillimin e tyre të vazhdueshëm personal dhe profesional, më synimin që ata të jenë efektivë dhe t'u përgjigjen me sukses sfidave aktuale dhe të reja. Po ashtu, nëpërmjet këtij plani strategjik, jo vetëm synohet të krijohet një mjedis miqësor për personelin, por edhe të krijohet dhe mirëmbahet "kultura e të mësuarit të vazhdueshëm".

Seksionet në vijim të këtij Plani Strategjik do të trajtojnë një sërë çështjesh që lidhen me hapat që janë ndjekur për të arritur këtë plan, synimet dhe pritshmëritë e tij, si dhe zbatimin dhe monitorimin e objektivave të përcaktuar.

Në pjesën e parë të këtij plani do të pasqyrohet një vlerësim i përgjithshëm i përpjekjeve, arritjeve dhe sfidave mbi zhvillimi personal, profesional, trajnimin dhe edukimin e vazhdueshëm për personelin e Universitetit të Tiranës. Pjesa e dytë fokusohet në qasjen strategjike që do të ndiqet, duke shpjeguar në mënyrë të detajuar fushat kryesore të Planit Strategjik, si dhe objektivat specifike që synohen të arrihen. Pjesa e tretë përcakton masat prioritare që do të zbatohen nga UT për secilën prej fushave dhe së fundmi, pjesa e katërt pasqyron planin e veprimit 2023, nëpërmjet të cilit do të synohet vënia në jetë e fushave dhe e objektivave specifike, ndarja e përgjegjësiive ndërmjet strukturave dhe përcaktimi i afateve për zbatimin e masave.

2. Qëllimi

Plani strategjik mbi zhvillimin profesional të personelit 2023-2028, ka si qëllim të koordinojë përpjekjet e Universitetit të Tiranës, ndaj një sërë sfidash në fushën e zhvillimit personal, profesional, trajnimit dhe edukimit të vazhdueshëm për personelin e UT-së.

Më konkretisht, kemi si qëllim:

"Garantimin e një mjedisi miqësor dhe të sigurt për zhvillimin e personelit, krijimi dhe mirëmbajtja e "kulturës së të mësuarit të vazhdueshëm" që nxisin, garantojnë dhe lejojnë zhvillimin e tyre të vazhdueshëm personal dhe profesional, më synimin që ata të jenë efektivë dhe t'u përgjigjen me sukses sfidave aktuale dhe të reja"



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

3. Gjendja Aktuale

Universiteti i Tiranës është institucioni më i madh publik i arsimit të lartë në Shqipëri. Aktualisht është i organizuar në 6 fakultete, 2 institute, 1 filial, si dhe ka në total 1324 punonjës me kohë të plotë, të ndarë përkatësisht në: 842 personel akademik me kohë të plotë, 325 personel ndihmës akademik dhe 157 personel administrativ.

Gjithashtu, ka edhe 1327 personel akademik me kohë të pjesshme (pedagogë të jashtëm), dhe 40 personel ndihmës akademik dhe administrativ me kontrata pune të përkohshme.

Gjatë periudhës 2020-2022 janë punësuar 103 personel akademik dhe 96 personel ndihmës akademik, të cilët janë target grupi i synuar për trajnim dhe zhvillim profesional.

Në Universitetin e Tiranës, me Vendimin nr.48, datë 25.11.2021, të Senatit Akademik të UT-së, është ngritur Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit (QVZHPT), qëllimi i së cilës është zhvillimi profesional, trajnimi dhe edukimi në vazhdimësi për personelin e Universitetit të Tiranës.

Qendra ka si mision zhvillimin dhe trajnimin e personelit të Universitetit të Tiranës, dhe aktorëve të tjerë, duke i specializuar në profesionist të fushës së tyre, gjithashtu synon kualifikimin dhe formimin cilësor profesional, duke krijuar nje kulturë pune të përkushtuar dhe bashkëpunuese.

Nga Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, për vitin akademik 2021-2022, janë kryer 19 (nëntëmbëdhjetë) trajnime për personelin e UT-së dhe studentët, të realizuara nga Profesor dhe Specialist të Fushave përkatëse të Universitetit të Tiranës si dhe nga Profesor dhe specialist të huaj.

Kërkesat gjithnjë e në rritje për zhvillim profesional dhe trajnim të vazhdueshëm implikojnë nevojën institucionale për ndërmarrjen e aksioneve të mëtejshme për ngritjen e kapaciteteve të duhura për plotësimin në kohë dhe me cilësi të këtyre kërkesave. Procesi i identifikimit të nevojave (i trajtuar në kapitullin pasardhës) është një proces dydimensional i fokusuar në nevojat e shprehura nga vetë punonjësit (kërkesës së bërë nga Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, sektori i burimeve njërzore, drejtuar gjithë personeli të UT-së), si dhe nga ana tjetër i shoqëruar me një analizë dhe vlerësim institucional të situatës aktuale të kapacitetit profesional dhe të nevojave për konsolidim/mbulim të këtyre nevojave të identifikuara.

4. Metodologjia

Siç është shpjeguar, ky plan strategjik është ndërtuar bazuar në kuadrin ligjor dhe institucional në fuqi së bashku me dokumentet dhe prioritetet përkatëse të Universitetit të Tiranës. Hartimi i këtij Plani Strategjik është planifikuar në kuadër të politikave të brendshme institucionale të zhvillimit, duke i dhënë një rol koordinues Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, si struktura me peshën më të madhe në menaxhimin e personelit dhe një rol ekzekutiv, Qendrës Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

Ky plan strategjik është konsultuar në të gjitha fazat e procesit, duke nisur nga analiza e riskut deri në miratimin e tij, të cilat kanë dhënë kontribut të veçantë gjatë procesit të hartimit të tij.

Në hartimin e këtij plani krahas infrastrukturës ligjore, në analizën për vlerësimin e gjendjes dhe planifikimin e prioriteteve, objektivave dhe alternativave të zhvillimit profesional për të ardhmen, janë marrë në konsideratë edhe gjetjet dhe rekomandimet e bëra nga raportet kombëtare të akreditimit, Kontrollit të Lartë të Shtetit apo raportet e brendshme të auditimit.

Procesi i hartimit të Planit Strategjik ka kaluar nëpër disa faza:

Faza e parë ka konsistuar në vlerësimin e nevojave të personelit të UT-së, për zhvillim profesional, si identifikimi i fushave të tyre të interesit për zhvillim dhe formim të vazhdueshëm, teknikat e nevojshme për zhvillim, etj.

Nevojat janë identifikuar së pari, gjatë muajit Shtator 2022, ku nëpërmjet emailit strukturat e burimeve njerëzore të secilës njësi, ka përcjellë nevojat përkatëse. Pas analizimit të këtyre nevojave, me anë të një pyetësi gjatë muajit Dhjetor 2022, secili personel ka shprehur nevojat konkrete.

Nëpërmjet këtij vlerësimi janë identifikuar mangësitë dhe nevojat në qasjen e zhvillimit profesional në UT. Këto nevoja janë zhvilluar gjatë fazës së dytë, ku janë ndërtuar më konkretisht qëllimet e politikave/politikat, objektivat specifike të Planit Strategjik, si dhe treguesit e performancës për të matur arritjet. Pjesë përbërëse e këtij vlerësimi kanë qenë dhe gjetjet dhe rekomandimet e ofruara nga raportet e pavarura kombëtare apo ato të brendshme, të cilat kanë trajtuar vit pas viti çështje që lidhen me zhvillimin e personelit në UT-ës. Gjithashtu, një sërë dokumentesh Strategjike dhe praktikash të mira ndërkombëtare në këtë fushë janë konsultuar dhe kanë shërbyer për fazën e tretë dhe të katërt të këtij procesi.

Gjatë fazës së tretë është kryer hartimi i dokumentit përfundimtar për vitin 2023-2028 dhe hartimi i Planit të Veprimit për zbatimin e Planit Strategjik për vitin 2023, ndërsa gjatë fazës së katërt është kryer procesi i konsultimit të dokumentit me personelin.

Procesi i vlerësimit të nevojave për trajnim dhe zhvillim realizohet prej Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, Sektorit i Burimeve Njerëzore, në bashkëpunim me Qendrën Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit ku identifikohen fushat ku personeli ka të nevojshme rritjen e mëtejshme të aftësive profesionale. Gjithashtu, nëpërmjet përdorimit të pyetësorëve, përdoruesve ju jepet mundësia e shprehjes së interesit të tyre për njohuri mbi fushat e statistikave.

Universiteti i Tiranës duke e vlerësuar aftësimin profesional të stafit si faktor të rëndësishëm në rritjen e performancës në punë, në planet e trajnimit i kushton një vëmendje të veçantë përmbushjes së nevojave për trajnim të identifikuar nga vetë personeli. Identifikimi i këtyre kërkesave për trajnim kryhet nëpërmjet shqyrtimit të:

- a. Tematikave të kërkuara nga personeli;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

b. Tematikave të sugjeruara në formularin e vlerësimit plotësuar nga të gjithë pjesëmarrësit gjatë trajnimeve të ofruara në vitin paraardhës nga QVZHPT;

Nëpërmjet procesit të vlerësimit të realizuar, u identifikua gjithashu nevoja e personelit mbi trajnime të tjera në 7(shtatë) fusha bazë të listuar si më poshtë:

1. Fusha mbi Burimet Njerëzore dhe barazinë gjinore
2. Fusha mbi protokoll-arkivën
3. Fusha mbi Teknologjinë dhe Informacionin
4. Fusha mbi Projektet
5. Fusha mbi Prokurimet
6. Fusha mbi Auditin e brendshëm
7. Fusha mbi Financën

Trajnuesi që do të merren me trajnimin e personelit, do të jenë pjesë nga personeli i Universitetit të Tiranës si dhe ekspert të fushës jashtë UT-së.



PLANI I TRAJNIMEVE 2023 – 2027 UNIVERSITETI I TIRANËS

FUSHA: MËSIMDHËNIE

Qëllimi: Qëllimi i procesit të mësimdhënies është transferimi i njohurive ku pedagogu identifikon, vendos objektivat mësimore dhe zbaton strategjinë e mësimdhënies dhe të nxënit. Qëllimi konsiston në përvetësimin e njohurive dhe aftësimin e studentëve për detyra apo aktivitete të mëtejshme.

Objektivat:

- Objektiva të qarta të mësimdhënies dhe menaxhimi i mirë i kohës
- Teknika bashkëkohore të mësimdhënies
- Teknikat e duhura të vlerësimit
- Motivimi i studentit dhe zhvillimi i kreativitetit

Nr	Temat	Target Grupi	Trajnuesi	Afati Kohor
1	Trajnim për metodologjitë e mësimdhënies	Personel akademik	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i pare
2	Trajnim për përfshirjen e teknologjise së informacionit në mësimdhënie	Personel akademik	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i dyte

Shënim: Ky plan do të rishikohet në varësi të ecurisë dhe kërkesave të reja.

FUSHA: KËRKIMI SHKENCOR

Qëllimi: Kërkimi shkencor është procesi sistematik dhe kreativ i ndërmarrë për rritjen dhe zbulimin e njohurive të reja. Këto njohuri mund të krijohen si rezultati i zhvillimit të koncepteve të reja ose nga avancimi i njohurive dhe teorive ekzistuese, duke derivuar në një kuptim të ri që nuk njihet dhe humultuar më parë. Qëllimi i kërkimit është të përmirësojë shoqërinë duke avancuar njohuritë përmes zhvillimit të teorive, koncepteve dhe ideve shkencore.

Objektivat:

- Forcimi i kapaciteteve kërkimore duke krijuar dhe zhvilluar një frymë bashkëpunuese për stafin akademik në rritjen e cilësisë kërkimore.
- Nxitja e bashkëpunimit të stafit akademik në transferimin dhe aplikimin e dijës duke krijuar një mjedis stimulues në procesin e transferimit dhe krijimit të punimeve shkencore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

- Zhvillimi i marrëdhënieve të reja të kërkimit shkencor me universitetet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar duke mësuar nga praktikatat më të mira në shkrimin dhe botimin e punimeve shkencore me scoups dhe monografive.

Nr	Temat	Target Grupi	Trajnuesi	Afati Kohor
1	Trajnim për metodologjinë dhe shkrimin e artikujve shkencore	Personel akademik	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i parë
2	Trajnim për botimet ne scopus dhe web of science	Personel akademik	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i dytë
3	Trajnim për shkrimin e monografive	Personel akademik	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i tretë

Shënim: Ky plan do të rishikohet në varësi të ecurisë dhe kërkesave të reja.

FUSHA: PROJEKTET

Qëllimi: Zhvillimin e kërkimit shkencor duke synuar rritjen e cilesisë dhe bashkëpunimin midis institucioneve të arsimit të lartë. Zhvillimi i kapaciteteve të kërkimit dhe inovacionit shkencor duke rritur aplikimet në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare duke i finalizuar këto aplikime në projekte fituese.

Objektivat:

- Njohja dhe përvetësimin me hapat e nevojshme për hartimin e një projekt propozimi cilësor, rëndësinë e një partneriteti efektiv dhe roli që ai luan në suksesin e projekt propozimi.
- Humultimi dhe përzgjedhja e projekteve në Europë dhe Shqipëri.
- Identifikimi i thirrjeve për një projekt, aplikimi dhe shkrimi i projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare duke u fokusuar në aspektet financiare dhe ato ligjore.
- Rritja e kapaciteteve në shkrimin e një projekt zhvillimi cilësor.

Nr	Temat	Target Grupi	Trajnuesi	Afati Kohor
1	Menaxhimi i programeve të mobilitetit (praktika nga vende te BE);	Personel akademik, personel i zyrave të projekteve në Rektorat dhe	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i parë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

		fakulteteve		
2	Ditët informuese që organizohen nga donatorë lidhur me aplikimet e projekteve;	Personel akademik, personel i zyrave të projekteve në Rektorat dhe fakulteteve	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i parë
3	Trajnime lidhur me Programet kombëtare dhe ndërkombëtare që financojnë kërkimin shkencor, inovacionin etj;	Personel akademik, personel i zyrave të projekteve në Rektorat dhe fakulteteve	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, AKKSHI, zyra Erasmus dhe institucione te tjera	Viti i parë
4	Krijimit të bashkëpunësorëve dhe konsorciumeve për realizimin e aplikimeve për projekte kombëtare dhe ndërkombetare.	Personel akademik, personel i zyrave të projekteve në Rektorat dhe fakulteteve	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i parë
5	Projektet EU për aplikimin dhe monitorimin e tyre.	Personel akademik, personel i zyrave të projekteve në Rektorat dhe fakulteteve	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, AKKSHI, zyra Erasmus dhe institucione te tjera, ekspert i jashtëm i fushës	Viti i dytë
6	Projektet Kombëtare për aplikimin dhe monitorimin e tyre, si projektet AKKSHI, MASR, Universiteti i Tiranës, etj.	Personel Akademik	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, AKKSHI, institucione te tjera, ekspert i jashtëm i fushës	Viti i dytë
7	Shkrimin dhe menaxhimin e projekteve të programeve të ndryshme europiane, si Erasmus+, Horizon Europe, AKKSHI, IPA,	Personel Akademik	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, AKKSHI, zyra Erasmus dhe institucione të tjera, ekspert i jashtëm i fushës	Viti i dytë
8	Koordinimi sa me efikas i aktiviteteve të projektit, përgatitja e materialeve kontrata/marrëveshje midis partnerëve.	Personel akademik, personel i zyrave të projekteve në Rektorat dhe fakulteteve	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, Personel Akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i tretë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

9	Përgatitja e raporteve dhe timesheets/dokumentacioni justifikues financiar, parashikim- planifikim dhe raportim financiar;	Personel akademik, personel i zyrave të projekteve në Rektorat dhe fakulteteve	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, Personel Akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i tretë
10	Trajnim mbi "design thinking & critical thinking"	Personel Akademik	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, Personel Akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i tretë
11	Trajnime për të rritur bashkepunimin në projekte edukuese, me fokus grupet vulnerabel, green economy, mbrojtje mjedisi, barazi gjinore etj, si dhe dhe mundësi përfitueshmërie në pjesëmarrje në universitete të huaja	Personel Akademik	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, Personel Akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i tretë
12	Njohja me "Politikat dhe procedurat për eliminimin e dhunës, ngacmimit dhe ngacmimit seksual" në kuadër të angazhimit që UT ka ndërmarrë të nxisë, promovojë dhe garantojë krijimin e një mjedisi të sigurtë dhe të shëndetshëm, duke mundësuar tolerancën zero ndaj këtyre fenomeneve jo vetëm brenda institucionit, por edhe në marrëdhëniet me studentët dhe publikun.	Personel akademik, ndihmës akademik dhe administrative në Rektorat dhe Fakultete	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik i FSHS	Viti i parë

Shënim: Ky plan do të rishikohet në varësi të ecures dhe kërkesave të reja.

FUSHA: MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Qëllimi: Relacionet me publikun janë një proces komunikimi strategjik që ndërton marrëdhënie reciproke të dobishme midis institucionit dhe publikut. Programi i trajnimit synon transmetimin e njohurive, komunikimin dhe krijimin e relacioneve pozitive nëpërmjet institucionit dhe palëve të tjera të interesit. Arritja e qëllimit do të realizohet nëpërmjet objektivave të mëposhtme të cilat kanë në fokus trajnimet mbi përdorimin inovativ të mediave sociale dhe krijimin e përmbajtjes cilësore në fushën e informimit të publikut për çështjet arsimore.

Objektivat:

- Krijimi i mundësive për stafin administrativ në zhvillimin e aftësive në përdorimin e rrjeteve sociale duke trajtuar risite, metodat e reja dhe inovative të publikimeve.
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe kujdesi i duhur ndaj përmbajtjes së publikimeve apo njoftimeve të institucionit në media të ndryshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

- Krijimi dhe ndërgjegjësimi i një mentaliteti negociues në krijimin e marrëdhënieve të forta me partnerë të huaj dhe jo vetëm.

Nr	Temat	Target Grupi	Trajnuesi	Afati Kohor
1	Trajnim mbi përdorimin efektiv të mediave sociale	Personel nga zyrat e komunikimit në fakultet dhe UT që mbulon rrjetet sociale	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, eksperte të jashtëm	Viti i parë
2	Trajnim në fushën e PR te IAL mbi mënyrat inovative	Personel administrativ nga zyrat e komunikimit në fakultet dhe UT që mbulojnë PR të institucionit dhe njësisë kryesore	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, staf akademik, ekspert i jashtëm i fushës	Viti i dytë
3	Aftësi negociimi për marrëdhënie ndërkombëtare - bashkëpunimi;	Personel administrativ dhe personel ndihmësakademik	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, staf akademik, ekspert i jashtëm i fushës	Viti i tretë

Shënim: Ky plan do të rishikohet në varësi të ecures dhe kërkesave të reja.

FUSHA: KOMUNIKIMI INSTITUCIONAL

Qëllimi: Komunikimi institucional kombinohet ndërmjet komunikimit administrativ brenda institucionit, departamenteve të njëjta apo të ndryshme, punonjësve, duke përfshirë dhe lidhjen e institucionit me shoqërinë dhe komunitetin. Komunikimi Institucional kontribuon në forcimin e institucionit dhe e bën menaxhimin publik të universitetit më transparent.

Objektivat:

- Nxitja dhe zhvillimi i marrëdhënieve cilësore ndërmjet institucionit dhe publikut të cilit i drejtohet, duke prezantuar qëllimet dhe aktivitetet e universitetit.
- Zhvillimi i një programi trajnimi që synon njohjen dhe zbatimin e standarteve, rregullave të komunikimit institucional, me stafin akademik të universitetit dhe/ose stafit ndihmës akademik duke përdorur instrumentat apo mjetet IT që mbështesin sigurinë e të dhënave sensitive në drejtim të zhvillimit institucional.

Nr	Temat	Target Grupi	Trajnuesi	Afati Kohor
1	Standartet e komunikimit institucional	Personel akademik, personel ndihmës akademik	Qendra e Trajnimit Virtual, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i parë
2	Njohja e rregulloreve të brendshme	Personel akademik, personel ndihmës akademik	Qendra e Trajnimit Virtual, personel Akademik, staf joakademik.	Viti i parë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

3	Përmirësimi i aftësive komunikuese dhe ndërpersonale në administratën universitare	Personel akademik, personel ndihmës akademik	Qendra e Trajnimit Virtual, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i dytë
4	Lidershipi e folura në publik	Personel akademik, personel ndihmës akademik	Qendra e Trajnimit Virtual, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i dytë
5	Komunikimi efektiv/ Çështje të diversitetit	Personel akademik, personel ndihmës akademik	Qendra e Trajnimit Virtual, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i tretë
6	Përpunimi teknik dhe shkencor i informacionit	Personel akademik, personel ndihmës akademik	Qendra e Trajnimit Virtual, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i tretë
7	Shkrim akademik/Përdorimi i gjuhës / termave diplomatike në komunikimin zyrtar	Personel akademik, personel ndihmës akademik	Qendra e Trajnimit Virtual, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i katërt
8	Mbrojtja e të dhënave personale dhe e drejta për informim;	Personel akademik, personel ndihmës akademik	Qendra e Trajnimit Virtual, Staf akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i katërt
9	Konfidencialiteti dhe ruajtja e të dhënave sensitivë në vendin e punës.	Personel akademik, personel ndihmës akademik	Qendra e Trajnimit Virtual, Staf akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i pestë
10	Siguria kibernetike mbi sistemin e Informacionit të UT	Stafi Akademik, sekretarite mesimore dhe prane departamenteve	Qendra e Trajnimit Virtual, Staf akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i pestë

Shënim: Ky plan do të rishikohet në varësi të ecurisë dhe kërkesave të reja.

FUSHA: VLERËSIMI I PERFORMANCËS NË UNIVERSITETIN E TIRANËS

Qëllimi: Realizimi i një procesi vlerësimi të drejtë, të pranueshëm në përzgjedhjen e stafit akademik dhe administrativë, në procesin e vlerësimit të performancës të stafit në përputhje me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Objektivat:

- Bashkëpunimi me akademikë, profesionistë dhe personalitete të mirënjohura në fushat e tyre të specializimit.
- Përcaktimi dhe zbatimi i proçdurave dhe metodave të sigurimit të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor si dhe funksionet themelore të Universitetit të Tiranës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

Nr	Temat	Target Grupi	Trajnuesi	Afati Kohor
1	Manuali i Vlerësimit të Performancës në UT	Personel akademik dhe ndihmësakademik	Qendra e Trajnimit Virtual, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i parë

Shënim: Ky plan do të rishikohet në varësi të ecurisë dhe kërkesave të reja.

FUSHA: VLERËSIMI I BRENDSHËM/AKREDITIMI

Qëllimi: Akreditimi është procesi i vlerësimit dhe njohjes së krediteve të një aktiviteti nga një institucion akreditues. Qëllimi i vlerësimit të brendshëm është sigurimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së aktiviteteve mësimore bashkëkohore duke ofruar praktika të mirëfillta biznisi për studentët e Universitetit të Tiranës.

Objektivat:

- Promovimi i edukimit të vazhdueshëm nëpërmjet krijimit të një udhëzuesi i cili do të kontribuojë si bazë në vlerësimin e brendshëm të procesit mësimor.

Nr	Temat	Target Grupi	Trajnuesi	Afati Kohor
1	Manuali i vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm	GVB në fakultetet, personel nga njësit e sigurimit të brendshëm të cilësisë në UT dhe në fakultete si dhe personel nga zyrat e sigurimit të cilësisë në Rektorat	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i parë

Shënim: Ky plan do të rishikohet në varësi të ecurisë dhe kërkesave të reja.

FUSHA: VLERËSIMI I CILËSISË NË UNIVERSITETIN E TIRANËS

Qëllimi: Sigurimi dhe përmbushja e standarteve të cilësisë, duke kontribuar dhe zhvilluar një staf të kualifikuar i cili përqëndrohet në realizimin me sukses të instrumentave të cilësisë në aktivitete të ndryshme si: Mësimdhënia, Kurrikula, Kërkimi Shkencor, Menaxhimi dhe Organizimi i Institucioneve të Arsimit të Lartë.

Objektivat:

- Implementimi i instrumentave në sigurimin e bashkëpunimit efektiv midis palevë të interesit për të pasur një produkt final i cili përmbush çdo kriter të cilësisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

- Realizimin e trajnimeve dhe manualit të cilësisë i cili do t'iu vijë në ndihmë strukturave të tjera departamentale të UT në shpërndarjen e knoë-hoë dhe praktikës më të mirë në sigurimin e të gjithë kriterëve të cilësisë.

Nr	Temat	Target Grupi	Trajnuesi	Afati Kohor
1	Manuali i Sigurimit të Cilësisë në Universitetin e Tiranës	Personel akademik, personel nga njësit e sigurimit të brendshëm të cilësisë në UT dhe në fakultete si dhe stafi i zyrave të sigurimit të cilësisë në Rektorat	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë	Viti i parë
2	Paketa e instrumentave të vlerësimit të Cilësisë në Universitetin e Tiranës	Personel akademik, personel nga njësit e sigurimit të brendshëm të cilësisë në UT dhe në fakultete si dhe stafi i zyrave të sigurimit të cilësisë në Rektorat	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë,	Viti i dytë

Shënim: Ky plan do të rishikohet në varësi të ecurisë dhe kërkesave të reja.

FUSHA: BURIMET NJERËZORE

Qëllimi: Universiteti vlerëson dhe mbështet gjithnjë e më shumë rolin e burimeve njerëzore (HR) për të rekrutuar, mbajtur, motivuar dhe angazhuar stafin ndërsa teknologjia zhvillohet dhe tregu i punës evoluon. Qëllimi kryesor është koordinimi dhe mbikëqyrja e ndërveprimeve të stafit të institucionit, duke përfshirë negociatat për pagat dhe përfitimet, punësimin e punonjësve të rinj dhe rekrutimin, duke shërbyer si urë lidhëse në respektimin e rregullave të punësimit dhe duke bashkëpunuar me drejtuesit për planifikimin strategjik afatgjatë të universitetit.

Objektivat:

- Zhvillimi i një kulturë pune të sigurt dhe pozitive.
- Motivimi për zhvillimin e talenteve dhe për të mbajtur një mjedis të qëndrueshëm pune.
- Ndërtimi i kanaleve të komunikimi ndërmjet departamenteve për të siguruar bashkëpunim efektiv.
- Planifikim strategjik në proceset e rekrutimit, seleksionimit dhe orientimin, menaxhimin dhe drejtimin e stafit të ri pjesë e institucionit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

Nr	Temat	Target Grupi	Trajnuesi	Afati Kohor
1	Informimi rreth ligjeve dhe praktikava të reja ligjore që kanë lidhje me punësimin dhe procesin e punës	Personel akademik, personel nga zyrat e burimeve njerëzore në fakultete dhe në Rektorat	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i parë
2	Menaxhimi i dosjeve të personelit	Personel nga zyrat e burimeve njerëzore në fakultete	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel nga zyrat e burimeve njerëzore në Rektorat dhe fakultete me më shumë eksperiencë	Viti i parë
3	Trajnim mbi ruajtjen kohore të dokumentacionit dhe gjeneraliteteve të ish-personelit të njësisë kryesore	Personel nga zyrat e burimeve njerëzore në fakultete	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel nga zyrat e burimeve njerëzore në Rektorat dhe në fakultete	Viti i parë
4	Marrëdhëniet e Punës	Personel akademik, personel ndihmësakademik	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i dytë
5	Etika dhe sjellja profesionale në vendin e punës	Personel akademik, personel ndihmësakademik	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i dytë
6	Metoda inovative të bashkëpunimit në grup;	Personel akademik, personel ndihmësakademik	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i dytë
7	Menaxhimi situacional/emocional gjatë bashkëpunimit në grup dhe me gjerë	Personel akademik, personel ndihmësakademik	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i tretë
8	Menaxhimi i kohës	Personel akademik, personel ndihmësakademik	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i tretë
9	Rekrutimi, intervistimi dhe seleksionimi i punonjësve	Personel nga zyrat e burimeve njerëzore në fakultete	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel nga zyrat e burimeve njerëzore në Rektorat, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i tretë
10	Proçesi i rekrutimit dhe planifikimi i Burimeve Njerëzore	Personel nga zyrat e burimeve njerëzore në fakultete	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel nga zyrat e	Viti i tretë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

			burimeve njerëzore në Rektorat, Ekspert i jashtëm i fushës	
11	Fuqizimi i aftësive menaxheriale në vendin e punës	Personel akademik, personel ndihmësakademik	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i katërt
12	Menaxhim dhe referim rasti në mjediset universitare	Personel akademik, personel ndihmësakademik	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i katërt
13	Fuqizimi i aftësive menaxheriale në vendin e punës	Personel akademik, personel ndihmësakademik	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i katërt
14	Vlerësimi i Performancës dhe motivimi në punë/ marrja e masave disiplinore.	Personel akademik, personel nga zyrat e burimeve njerëzore në Rektorat dhe fakultete	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i katërt
15	Impakti i ekuilibrit mes jetës personale dhe profesionale në efektivitetin në punë, teknika dhe ndërhyrje	Personel akademik, personel ndihmësakademik	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i pestë
16	Vendosja dhe funksionimi i sistemit dixhital për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (HRMIS)	Personel akademik, personel nga zyrat e burimeve njerëzore në Rektorat dhe fakultete	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel nga Drejtorja e IT dhe Burimeve Njerëzore	Viti i pestë
17	Oportunitete të barabarta mes gjinive të ndryshme dhe shmangia e abuzimit seksual: format e shfaqjes, lufta ndaj tij	Personel akademik, personel ndihmësakademik	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i parë
18	Hartimi i planeve buxhetore të barazisë gjinore në IAL	Personel akademik, Pika fokale Gender në UT	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i parë

Shënim: Ky plan do të rishikohet në varësi të ecurisë dhe kërkesave të reja.

FUSHA: MBI TEKNOLOGJINË E INFORMACIONIT

Qëllimi: Qëllimi i teknologjisë së informacionit është modernizimi i sistemit arsimor dhe bërja e tij më efikas dhe produktiv për tregun dhe për vendin. Krijimi i bazave të dhënave arsimore për një planifikim efektiv arsimor dhe zhvillim politikash dhe vendimmarrjesh arsimore të përshtatshme.

Objektivat:

- Integrimi i teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies në të gjithë sistemin arsimor.
- Krijimi i kapaciteteve njerëzore profesionale nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm në përdorimin efikas të programeve softwarike në administrimin e bazës së të dhënave, përpunimin e tyre dhe shpërndarja në kanale të ndryshme dixhitale.

Nr	Temat	Target Grupi	Trajnuesi	Afati Kohor
1	Trajnim mbi sistemin e-student të UT	Personel akademik, sekretarite mësimore në fakultete dhe stafi ndihmësakademik në departamente	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel nga Drejtoria e IT	Viti i parë
2	Trajnime mbi sigurinë dhe administrimin e bazës së të dhënave në UT	Personel akademik, sekretarite mësimore në fakultete dhe stafi ndihmësakademik në departamente	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, personel nga Drejtoria e IT	Viti i dytë
3	Trajnime Statistika me program kompjuterikë SPSS	Personel akademik	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i dytë
4	Përdorimi i programeve inovative software për përpunim të dhënash, prezantimeve etj, sipas nevojave të punës;	Personel akademik, personel ndihmësakademik	Qendra e Trajnimit Virtual, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i tretë
5	Trajnim mbi përdorimin e programeve edituese të fotove, videove për publikime në faqen e web dhe në mediat sociale.	Personel nga zyrat e komunikimit që mbulon manaxhimin e web-eve zyrare dhe rrjeteve sociale në fakultete	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel Akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i tretë
6	Trajnime për platforma elektronike CISCO, TEAMS etj	Personel akademik, personel ndihmësakademik	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i katërt
7	Trajnim për mledhjen e statistikave gjinore sipas ISCEED	Pika fokale gendet në UT, personeli i zyrave të burimeve njerëzore në UT dhe fakultetet si dhe sekretarite mësimore të bachelor, master dhe doktoraturë	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i pestë
8	Menaxhimi i të dhënave në database;	Personel akademik, personeli i zyrave të burimeve njerëzore në	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, drejtoria e IT	Viti i pestë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

UT dhe fakultetet si
dhe sekretariatë
mësimore të bachelor,
master dhe doktoraturë

ne UT

Shënim: Ky plan do të rishikohet në varësi të ecurisë dhe kërkesave të reja.

FUSHA: QENDRA E KARRIERËS

Qëllimi: Të mbështesë dhe të inkurajojë studentët dhe Alumnin në zhvillimin e potencialit të tyre për një përfaqje më të mirë në tregun e punës, duke rritur kështu numrin e të punësuarve në fushën e tyre të studimit.

Objektivat:

- Orientimi i studentëve rreth zhvillimit dhe planifikimit të karrierës.
- Përgatitja e studentëve për punësim dhe edukimi i vazhdueshëm duke i mundësuar praktika pune në institucione publike dhe private.
- Organizimi i panairove, seminareve, tryezave të rumbullakëta, konferencave, me qëllim orientimin dhe përgatitjen e studentit drejt tregut të punës.

Nr	Temat	Target Grupi	Trajnuesi	Afati Kohor
1	Gjurmimi i studentëve	Personel akademik, personel nga zyrat t karrierës në Rektorat dhe fakultete	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, personel nga qendrat e karrieres, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i parë
2	Organizimi i Panairove të puneve	Personel akademik, personel nga zyrat t karrieres në Rektorat dhe fakultete	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel nga qendrat e karrieres, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i dytë
3	Studimi tregut	Personel akademik, personel nga zyrat e karrieres në Rektorat dhe fakultete	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i tretë
4	Krijimi/përditesimi i rrjetit Alumni	Personel akademik, personel nga zyrat e karrierës në Rektorat dhe fakultete	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel nga qendrat e karrierës	Viti i katërt

Shënim: Ky plan do të rishikohet në varësi të ecurisë dhe kërkesave të reja.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

FUSHA: PROKURIMET PUBLIKE

Qëllimi: Azhurnimi mbi legjislacionin dhe rregullat për procedurat e prokurimit nga autoritetet dhe entet kontraktore për kontratat publike dhe konkurset e projektimit.

Objektivat:

- Trajnime mbi tërësinë e procesit të prokurimit publik, nga planifikimi i prokurimit dhe përgatitja e dokumentacionit përkatës deri te menaxhimi i kontratës dhe vlerësimi i performancën së kontratës.
- Sigurimi i efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik.
- Të sigurojë besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Nr	Temat	Target Grupi	Trajnuesi	Afati Kohor
1	Legjislacioni i Prokurimit Publik	Personeli administrativ në Rektorat dhe fakultete që mbulon prokurimet	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i parë
2	Sistemi i prokurimit publik dhe parimet e tij	Personeli administrativ në Rektorat dhe fakultete që mbulon prokurimet	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i parë
3	Konflikti i interesave në prokurimin publik	Personel administrativ në Rektorat dhe fakultete që mbulon prokurimet	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i parë
4	Specifikimet teknike, kriteret për kualifikim dhe kriteret e përzgjedhjes së fituesit	Personel administrativ në Rektorat dhe fakultete që mbulon prokurimet	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i dytë
5	Llojet e procedurave të prokurimit publik sipas legjislacionit shqiptar	Personel administrativ në Rektorat dhe fakultete që mbulon prokurimet	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i dytë
6	Zhvillimi i procesit të prokurimit publik	Personel administrativ në Rektorat dhe fakultete që	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i dytë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

		mbulon prokurimet		
7	Sistemi i rishikimit në prokurimin publik	Personel administrativ në Rektorat dhe fakultete që mbulon prokurimet	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i tretë
8	Sistemi i prokurimit elektronik në Shqipëri	Personeli administrativ në Rektorat dhe fakultete që mbulon prokurimet	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i tretë
9	Menaxhimi i kontratës	Personeli administrativ në Rektorat dhe fakultete që mbulon prokurimet	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i tretë
10	Regjimi i Komisionit Evropian për Prokurimin Publik dhe situata aktuale dhe ndryshimet e nevojshme legjislative për përafrimin e mëtejshëm të sistemit të prokurimit publik shqiptar me atë evropian.	Personeli administrativ në Rektorat dhe fakultete që mbulon prokurimet	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i tretë
11	Prokurimet me vlera të vogla lidhur me ankesat operatorëve ekonomike në sistemin APP	Personeli administrativ në Rektorat dhe fakultete që mbulon prokurimet	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i katërt

Shënim: Ky plan do të rishikohet në varësi të ecuresë dhe kërkesave të reja.

FUSHA: MBI AUDITIN E BRENDSHËM

Qëllimi: Të ndihmojë të kuptuarit të parimeve, standardeve, normave, teknikave të auditimit dhe zbatimin e tyre në përgatitjen dhe analizën e informacionit financiar.

Objektivat:

- Krijimin e kapaciteteve profesionale të cilat rrisin ndërgjegjësimin e rëndësishëm të parimeve të auditimit në sektorin publik.
- Ndihmon në përmirësimin e kontroleve, zvogëlimin e rreziqeve me të cilat përballen institucionet e arsimit dhe rekomandon se si mund të funksionojnë subjektet në mënyrë më efektive dhe ekonomike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

Nr	Temat	Target Grupi	Trajnuesi	Afati Kohor
1	Auditim i brendshëm në sektorin publik	Personel administrativ në Rektorat dhe fakultete që mbulon procese që janë objekt auditimi	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, Drejtoria e Auditit të Brendshëm në UT, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i dytë
2	Auditim i fondeve të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare	Personel administrativ në Rektorat dhe fakultete që mbulon procese që janë objekt auditimi	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, Drejtoria e Auditit të Brendshëm në UT, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i tretë
3	Manuali i auditimit të brendshëm	Personel administrativ në Rektorat dhe fakultete që mbulon procese që janë objekt auditimi	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, Drejtoria e Auditit të Brendshëm në UT, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i tretë

Shënim: Ky plan do të rishikohet në varësi të ecurisë dhe kërkesave të reja.

FUSHA: MBI FINANCËN

Qëllimi: Azhornimi mbi legjislacionin dhe rregullat për procedurat e planifikimit në aktivitetet dhe transaksionet financiare të institucionit duke përfshirë tregues të performancës si dhe mekanizma të efektshëm të kontrollit financiar.

Objektivat:

- Krijimi i kapaciteteve profesionale në menaxhimin dhe kontrollin e përgjithshëm të të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve dhe përdorimin transparent të fondeve buxhetore të aprovuara.
- Përmirësimi i procesit të menaxhimit të vlerësimit dhe kontrollit financiar sipas teknikave dhe metodave të miratuara nga legjislacioni vendas.

Nr	Temat	Target Grupi	Trajnuesi	Afati Kohor
1	Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit	Personel administrativ	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i parë
2	Legjislacioni dhe Sistemi Tatimor në Republikën e Shqipërisë	personel administrativ i zyrave	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe	Viti i dytë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

		të financës në Rektorat dhe fakultete	Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	
3	Hartimi i projekt buxheteve PBA	Personel administrativ i zyrave të financës në Rektorat dhe fakultete	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i dytë
4	Kontabiliteti, Sistemi i Informacionit dhe Informatizimit financiar	Personel administrativ i zyrave të financës në Rektorat dhe fakultete	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i tretë
5	Analiza e Pasqyrave Financiare	Personel administrativ i zyrave të financës në Rektorat dhe fakultete	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i tretë
6	Standartet e Raportimit Financiar bazuar në SKK, (SNK dhe menaxhimi i aseteve fikse)	Personel administrativ i zyrave të financës në Rektorat dhe fakultete	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, Personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i katërt
7	Raportimi financiar – Legjislacioni, Rregullatorët dhe palët e interesuara	Personel administrativ i zyrave të financës në Rektorat dhe fakultete	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i katërt
8	Prezantim i përgjithshëm i SKK- ve dhe SNRF-ve efektivisht në zbatim	Personel administrativ i zyrave të financës në Rektorat dhe fakultete	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i pestë
9	Menaxhimi i Aseteve Fikse	Personel administrativ i zyrave të financës në Rektorat dhe fakultete që mbulon manaxhimin e aseteve	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, personel akademik, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i pestë

Shënim: Ky plan do të rishikohet në varësi të ecures dhe kërkesave të reja.

FUSHA: PROTOKOLL-ARKIVI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

Qëllimi: Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të punonjësve të protokollit dhe arkivave të njëjësive të universitetit në ofrimin e shërbime administrative cilësore dhe efektive ndaj palëve të interesit.

Objektivat:

- Njohja e legjislacionit përkatës për arkivat, rregulloren për arkivat dhe mënyrën se si dokumentet duhet të sistemohen në dosjet përkatëse.
- Trajnime mbi procedurat dhe problemet që lidhen me ruajtjen e dokumentave, si siguria, vula, regjistri i protokollit dhe mënyrën se si shkresa të futet në dosjen korresponduese.

Nr	Temat	Target Grupi	Trajnuesi	Afati Kohor
1	Administrimi dhe ruajtja e dosjeve personale të personelit	Personel ndihmësakademik në rektorat dhe fakultete që mbulon proceset e protokoll arshivës	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i parë
2	Organizimin dhe unifikimin e dokumentacionit të brendshëm dhe zyrtar, bazuar dhe në komunikimin midis zyrave	Personel ndihmësakademik në rektorat dhe fakultete që mbulon proceset e protokoll arshivës	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i dytë
3	Arkivimin dhe përpunimin shkencor të dokumenteve të prapambetura	Personel ndihmësakademik në rektorat dhe fakultete që mbulon proceset e protokoll arshivës	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i tretë
4	Trajnim lidhur me protokollimin e dokumentacionit	Personel ndihmësakademik në rektorat dhe fakultete që mbulon proceset e protokoll arshivës	Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, Ekspert i jashtëm i fushës	Viti i katërt

Shënim: Ky plan do të rishikohet në varësi të ecurisë dhe kërkesave të reja.